

STATUTI I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“Life Med Diagnostics” shpk

Bazuar ne ligjin nr. 9901, date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, te ndryshuar

Ne kete statut:

- “Ligji” eshte Ligji nr. 9901, date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, i ndryshuar
 - “Statut”eshte statuti i shoqerise
-

KREU I:

ORTAKET, EMERTIMI- OBJEKTI- SELIA- KOHEZGJATJA

NENI 1 Ortaket themelues

Shoqeria me pergjegjesi to kufizuar **“Life Med Diagnostics” sh.p.k.**, krijohet nga ortaket themelues si me poshte:

- Ortaku themelues Anxhela Zenuni , e bija e Arian Zenuni, lindur me 24.06.1993, ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plete juridike per te vepruar, mbajtes i kartes se identitetit numer I26025023B

NENI 2 Emertimi dhe Forma Ligjore

2.1 Shoqeria tregtare eshte shoqeri vendase dhe emertohet **“Life Med Diagnostics” shpk**, emertim i cili do te jete i stampuar dhe ne vulen e shoqerise.

2.2 Forma ligjore

Shoqeria eshte e formes me pergjegjesi te kufizuar (sh.p.k.), ne baze te ligjit *nr. 9901, date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”*. Shoqeria mund te shnderrohet ne nje forme tjeter me vendimin e Asamblese se Ortakeve sipas parashikimeve ligjore te *ligji nr. 9901, date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”*.

NENI 3 Selia e shoqerise

Selia e shoqerise shoqerise eshte ne adresen: Rruga “Arkitekt Kasemi”, Nr.22 Hodo Shpk , Tirane, Shqiperi.

Shoqeria ka te drejte te krijoje dege, filiale dhe/ose zyra perfaqesimi ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise ose jashtë saj. Me vendim të Asamblese se Ortakeve, mund të krijohen ose anullohen (ne rast se jane celur), seli, filiale, agjensi dhe perfaqesi si ne qytete të tjera të Shqiperise dhe jashtë saj. Njesite e tjera strukturore të shoqerise si dege apo perfaqesi dhe jashtë shtetit krijohen kur nje gje të tillë parashikon dhe lejon dhe legjislationi i vendeve të huaja, normat e se drejtes nderkombetare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

NENI 4 Objekti i shoqerise

Shoqeria do te kete si objekt te veprimtarise te saj:

Laborator mjekesor. Sherbime laboratorike mjekesore (analiza klinike, biokimike, imunologjike dhe hormonale).

Shoqeria do te zhvilloje cdo veprimtari ekonomike te ligjshme sipas licenses se dhene nga organet kompetente si dhe cdo veprimtari tjeter ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e qellimit te shoqerise e qe nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Shoqeria do te respekoje te gjitha ligjet dhe rregulloret qe kane te bejne me aktivitetin e saj. Kjo nenkupton praktikat me te mira te etikes.

Per te realizuar qellimet e saj Shoqeria do te bashkepunoje me persona fizike dhe /ose juridike, vendas ose te huaj.

Objekti i shoqerise mund te ndryshoje, te zgjerohet ose te pakesohet ne baze te vendimit te Asamblese te Ortakeve.

NENI 5 Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqërisë është e pakufizuar.

NENI 6 Kapitali

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 10.000 (dhjete mijë) leke.

Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e meposhtme:

- Ortaku themelues Anxhela Zenuni: Zoterues i nje kuote me vlore te pergjithshme 10.000 leke qe perben 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise;

Ortaket kane pavaresi ligjore, organizative si dhe të drejta pronesie mbi cdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi cdo lloj pasurie tjeter të fituar ne rruge të ligjshme. Shoqeria perjigjet vetem me kapitalin e saj.

NENI 7

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj tregtare ne perputhje të plote me Legjislacionin Shqiptar ne fuqi si dhe mbi bazen e Statutit të saj.

KREU II KUSHTET EKONOMIKE

NENI 8

Shoqeria cel llogari bankare ne monedhen vendase dhe cdo lloj valute, ne Banka vendase ose të huaja, private apo shteterore, me qellim per të kryer veprimet e nevojshme per ushtrimin dhe perballimin financiar të aktivitetit të saj.

NENI 9

Pjeset e kapitalit themelor, jane lirisht të transferueshme ne rruge trashegimie sipas dispozitave të Kodit Civil.

Pjeset e kapitalit themeltar mund te transferohen vetem me akt notarial. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve te shoqerise.

Pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri vetem me miratimin e shumices se ortakeve qe perfaqesojne te pakten 50% te pjesave te kapitalit themeltar dhe ne perputhje me nenin 10.

NENI 10

Me vendim të ortakeve te shoqerise, shoqeria mund të zgjeroje aktivitetin e saj tregtar dhe ne drejtime të tjera të cilat jane me interes per mbarevajtjen e shoqerise.

KREU III ORGANET DREJTUESE TË SHOQERISE

NENI 11

Asambleja e per gjithshme eshte Organi me i Larte Drejtues dhe Vendimmarres i shoqerise dhe ajo ushtron të gjitha kompetencat qe i njeh ligji "Per shoqerite tregtare".

Asambleja e per gjithshme mund t'a delegoje kompetencat administratorit të caktuar prej saj sipas parashikimeve ne Statut.

NENI 12

Shoqeria do te administrohet nga nje Administrator i Vetem.

Administrator i shoqerise "**Life Med Diagnostics**" sh.p.k. eshte Znj. Anxhela Zenuni , shtetas Shqiptare, i biri Arian Zenuni, lindur ne Tirane Shqiperi, me 24.06.19963, banues ne Tirane, mbajtes i Leternjoftimit numer J35624053M, me nje afat emerim 3 (tre) vjecar.

Administratori emerohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Pergjithshmeme me shumice te thjeshte.

Administratori qendron ne detyre deri ne revokimin e mandatit te tij nga Asambleja.

Administratori mban individualisht per gjegjesi perball shoqerise ose te treteve per shkeljet e mundshme te ligjt dhe/ose te Statutit apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Administratori mund te zevendesohet ne cdo moment me vendim te autoriteteve gjyqesore shqiptare per shkelje te ligjt.

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredheniet me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ua njeh shprehimisht ortakeve. Perfaqesimi i shoqerise ne marredheniet me të tretet si brenda dhe jashte shtetit si rregull i per gjithshem i perket Administratorit te shoqerise.

Administratori:

- i. kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- ii. përfaqëson shoqërinë tregtare;
- iii. kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- iv. përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përparras asamblesë së përgjithshme për miratim;
- v. krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcenojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- vi. kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- vii. raporton përparras asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- viii. kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Paga e administratorit percaktohet me vendim te Asamblese se Ortakeve.

NENI 13

Thirrja dhe zhvillimi i mbledhjeve

Mbledhjet zhvillohen ne seline e shoqerise ne territorin e Republikes se Shqiperise por mund te zhvillohen dhe jashte selise.

Njoftimi (lajmerimi) kryhet me shkrim, me telegram, me leter rekomande, poste elektronike (e-mail) ose poste tjeter te regjistruar, jo me vone se 7 dite perpara dates se zhvillimit te mbledhjes. Lajmerimi permban daten, vedin, oren dhe rendin e dites se mbledhjes. Lajmerimi behet nga administratori i shoqerise.

NENI 14

Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për administratorin, likuiduesit, dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Asambleja e përgjithshme e shoqerise ka edhe keto të drejta dhe detyra kryesore:

Të marre pjese ne drejtimin dhe administrimin e gjithanshem të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise dhe të cdo veprimtarie tjeter të saj, kur ajo ushtrohet ne perputhje me Ligjet, dhe Statutin e saj. Të kerkonte dhe t'i jepen të gjitha informatat qe kane të bejne me gjendjen tregtare dhe financiare të veprimtarise se shoqerise, si dhe i të gjitha dokumentave të perpunuara nga shoqeria;

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo person i tretë. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Ne rast vendimesh te zakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese jane te pranishem ortaket zoterues te me shume se 30% (tridhjete perqind) te kuotave. Nese Asambleja e Pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se Kuorumi ne thirrjen e pare, Asambleja e Pergjithshme mund te mblidhet perseri me te njejtin rend dite brenda dhe jo me vone se 30 (tridhjete) dite nga thirrja e pare. Ne rast vendimesh te zakonshme, keto te fundit merren me voten pro te shumices se ortakeve te pranishem apo te perfaquesuar.

Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te zakonshme per çështjet e mëposhteme:

- (a) Percaktimin e politikave tregtare;
- (b) Emerimin dhe shkarkimin e administratorit, eksperteve kontabel te autorizuar dhe likuiduesve;
- (c) Miratimin e shperblimeve per personat e permendur ne piken b;
- (d) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- (e) Perfaqesimin e Shoqerise ne gjykatë dhe ne procese te tjera ndaj Administrimit dhe/ose Administratorit;
- (f) Çdo çështje tjeter te percaktuar nga Ligji apo Statuti.

Vendime te Jashtezakonshme

Ne rast vendimesh te jashtezakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese jane te pranishem aksionaret zoterues te me shume se 50% (pesedhjete perqind) te ortakeve me te drejte vote. Nese Asambleja e Pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se Kuorumi ne thirrjen e pare, Asambleja e Pergjithshme mund te mblidhet perseri me te njejtin rend dite brenda dhe jo me vone se 30 (tridhjete) dite nga thirrja e pare. Ne rast vendimesh te jashtezakoneshme,

keto te fundit merren me voten pro te $\frac{3}{4}$ (tre te katertat) e ortakeve te pranishem apo te perfaqesuar.

Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te jashtezakonshme per çeshtjet e meposhteme:

- (a) Ndryshimin e Statutit te Shoqerise;
- (b) Zmadhimin ose zvogelimin e Kapitalit;
- (c) Shperndarjen e fitimeve vjetore;
- (d) Riorganizimin, shperndarjen, shnderrimin, bashkimin, shkrirjen, ndarjen, prishjen apo likuidimin e Shoqerise, ose riorganizimin e Shoqerise ne nje forme tjeter;
- (e) Cdo ceshtje tjeter te percaktuar nga Ligji apo Statuti.

NENI 15

Asambleja e Ortakeve dhe administratori i shoqerise, ka të drejte qe per nevojat e ushtrimit normal të aktivitetit të shoqerise, të marrin ne pune shtetas të ndryshem, duke lidhur kontrate sipas parashikimeve te legjislacionit ne fuqi si dhe ne pershtatje me rregullat e brendshme të disiplines teknike dhe të punes të caktuara nga vete Shoqeria. Kontrata te tilla do te nenshkruhen nga Administratori.

KREU IV

BILANCI, TË ARDHURAT DHE SHPERNDARJA E SHOQERISE

NENI 16

Viti fiskal fillon ne 1 janar dhe perfundon ne 31 dhjetor te cdo viti.

Per nxjerjen e rezultatit kontabel të shoqerise, mbi bazen e aktivit dhe pasivit, ngarkohet nga Asambleja e Ortakeve nje ekspert kontabel i autorizuar.

NENI 17

Ekspertet kontabel te autorizuar

Auditimi i brendshem i Shoqerise do te behet nga eksperte kontabel te autorizuar, te caktuar per nje vit fiskal. Ekspertet kontabel te autorizuar emerohen nga Asambleja e Pergjithshme me vendim te zakonshem.

NENI 18

Nxjerra e rezultateve të Bilancit vjetor duhet bere me saktesi dhe duke respektuar të gjitha rregullat qe percaktohen ne Ligjin mbi Kontabilitetin dhe atyre të Sistemit të Taksave, qe jane të detyrueshme per t'u zbatuar nga cdo subjekt privat, qe ushtron veprimtari tregtar.

Kontabiliteti mbahet ne gjuhen Shqipe, ne monedhen Shqiptare dhe pasqyrohet ne librat perkates. Shoqeria mund te kete edhe llogari te vecanta ne valute. Shoqeria mund te marre financime nga ortaket, institucionale financiare qe operojne ne Shqiperi ose jashte saj. Per kete qellim shoqeria mund te jape si garanci barre mbi pjeset e kapitalit ose sende te paluajtshme, me autorizim te Asamblese se Ortakeve.

NENI 19

Bilanci Kontabel vjetor miratohet mbi bazen e vendimit me shkrim nga ortaket, i cili jo vetem qe dokumenton miratimin e tyre por vendos ne lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave te zhvillimit te metejshem te shoqerise dhe garantimin e veprimtarise se rregullt te saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit te vecante etj.

NENI 20

Të ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit te fondeve ligjore te mesiperme dhe te atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj te treteve, mund te ndahen ndermjet ortakeve ne raport me pjeset qe ata zoterojne ne kapitalin e shoqerise.

Asamblea percakton pjesen qe iu takon ortakeve ne forme dividendesh.



NENI 21

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkaku, edhe para plotesimit të afatit per të cilën eshte krijuar sic mund të jene:

- a) me vendim te Asamblese se per gjithshme
- b) Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit të metejshem të veprimtarise se saj.
- c) me hapje e procedurave te falimentimit
- d) Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Asambleja e Pergjithshme merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese "Shoperi ne likuidim e siper".

NENI 22

Afati i emerimit të likuidatorit, publikohet sipas kushteve qe parashikon ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentat qe duhen depozituar ne Aneksin e Regjistrat Tregtar.

NENI 23

Cdo mosmarreveshje apo konflikt qe mund të linde gjate ushtrimit të veprimtarise se Shoqerise si rregull dhe per gjithesish ortaket duhet ta zgjidhin me mirekuptim, ne te kunderten, kompetente per zgjidhjen e tyre jane Gjykatat Shqiptare.

NENI 24

Per cfare nuk eshte shprehur ne kete statut, do te rregullohet ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe udhezimet plotesuese dhe të ligjshme të dhena nga Asambleja e Pergjithshme.

NENI 25

Ky statut u redaktua ne 7 origjinale ne gjuhen shqipe me permbajtje dhe vlere te njepte juridike.

THEMELUES TE SHOQERISE

"Life Med Diagnostics" sh.p.k.

ORTAKET THEMELUES

Anxhela Zenuni

D+: 28/09/2021